



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) e Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 110/21), nenet 65-ç, paragrafi (3) dhe 65-d, paragrafi (1) i Ligjit për Banka ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16, 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 101/19 dhe 122/21), dhe pika 11) dhe 14) nga Vendimi për metodologjinë për përcaktimin e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 26/17 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr.98/21 dhe 149/21) Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për lartësinë e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të ekspozimeve ndaj vendeve të tjera në tremujorin e parë të vitit 2024

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 2/23)

1. Përcaktohet norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lartësi prej 0,75%.

2. Përcaktohet norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve ndaj vendeve të tjera në lartësi të normave të përcaktuara nga autoritetet kompetente të vendeve të tjera të publikuara në faqen e internetit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Bankat detyrohen të zbatojnë këtë vendim dhe të përfshijnë normat nga pikat 1) dhe 2) të këtij vendimi në përlogaritjet e përcaktimit të normës specifike të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për tremujorin e parë të vitit 2024.

4. Nga data 1 gusht 2023 deri më 30 shtator 2023, në përlogaritjet për përcaktimin e shkallës specifike të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit zbatohet në pajtueshmëri me Vendimin për lartësinë e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të ekspozimeve ndaj vendeve të tjera ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 175/22).

Nga data 1 tetor 2023 deri më 31 dhjetor 2023, në përlogaritjet për përcaktimin e shkallës specifike të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, normat e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit zbatohen në përputhje me Vendimin për lartësinë e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të ekspozimeve ndaj vendeve të tjera ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 216/22)

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V nr. 02-15/XXII-2/2022

28 dhjetor 2022

Shkup

Guvernatorja

**dhe kryesuesja e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска**